



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, dhe neni 4 nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve të parashtruara, KSHPK duke vepruar sipas denoncimit të parshtruar nga parashtrues i njohur në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më 01.09.2021, morri:

### VENDIM

Denoncimi me numër 12 - 2367/1 i datës 27.01.2021 i dorëzuar nga parashtrues -----  
-----nga-----, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka kompetenc për veprim në lëndën me numër 12- 2367/1 e formuar pas denoncimit nr.12-2367/1 të datës 27.01.2021.

Lënda me numër 12 -2367 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetërorë, me arsyetim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

### Arsyetim

Lënda me numr 12 - 2367/1 të vitit 2021, e formuar pas denoncimit me numër 12 - 2367/1 të datës 12.06.2021, e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga parashtrues i njohur, „----- nga -----.

Në denoncimin e dorëzuar jan nxjerrë pohime për pakënaqësi me trajtimin e rastit konkret në Gjykatën Themelore Civile Shkup nga viti 2016, pas së cilës gjyqtari i rastit ishte -----  
- -, dhe për mospranimin e një aktgjykimi mbi një padi mbi të cilën është formuar çështja gjyqësore. Parashtruesi i denoncimit dyshon se dikush i bëri presion personit në fjalë që ta refuzonte kërkesën, kështu që aktgjykimi nuk ishte përgatitur, edhe pse ka kaluar një periudhë më e gjatë kohore nga seanca e mbyllur gjyqësore.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit të dorëzuar dhe dokumentacionit të paraqitur, KSHPK -ja arrin në përfundimin se veprimet e denoncuara nuk janë aktivitete për të cilat KSHPK - ja ka juridiksion për të vepruar, por janë aktivitete për të cilat juridiksion ka një organ tjetër, pas së cilës KSHPK vlerësoi se nuk ka juridiksion për veprim në rastin e lëndës, denoncimi të refuzohet, lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHETETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Nënkryetar  
Goran Trpenoski

Dorëzuar deri te:

[Arkiv]

Parashtruesi

Punoi: J.C.

Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

